



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

NJOFTIM PËR KOHËN, VENDIN E MBAJTJES DHE PAGESËN PËR PROVIM TË JURISPRUDENCËS

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për dhënien e provimit të Jurisprudencës për afatin Prill 2024, se pjesa e Provimit të Jurisprudencës me shkrim do të mbahet me datat si në vijim:

Lënda: E Drejta Penale do të mbahet me datë 25 Maj 2024 (e Shtune) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.

Lënda: E Drejta Civile do të mbahet me datë 26 Maj 2024 (e Diele) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.

Kandidatët janë të obliguar që të paraqiten për regjistrim jo më vonë se ora 08:00.

Kandidatët të cilët nuk paraqiten në orarin e sipër cekur ose paraqiten pasi që të gjithë kandidatët hynë në sallën e mbajtjes së Provimit të Jurisprudencës, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim.

KANDIDATI ËSHTË I OBLIGUAR që të marrë me vete dokumentin personal për identifikim (letërnjoftimin ose pasaportën). Nuk do të pranohet asnjë dokument tjetër.

KANDIDATIT I LEJOHET që në Provim të Jurisprudencës me shkrim, me vete të ketë vetëm: Legjislacionin përkatës në fuqi, lapsin kimik me ngjyrë të kaltër.

KANDIDATIT NUK I LEJOHET që të kenë në SALLË: asnjë lloj telefoni, kompjuteri, kamere, dëgjuese-kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji.

KANDIDATIT NUK I LEJOHET që të kenë në posedim: asnjë lloj shënimi, materiali lexues apo material përshkrimi, forma të akteve gjyqësore dhe orë dore. Shkelja e rregullave, nga ana e kandidatit rezulton me diskualifikimin e tij dhe shpalljen e provimit të pavlefshëm për të.

Vendi i mbajtjes së Provimit të Jurisprudencës me shkrim është kampusi i ri i Universitetit "Isa Boletini"- Mitrovicë, Rr. Ukshin Kovaçica. 40000 Mitrovicë.

NJOFTIM PËR KOHËN E PAGESËS PËR PROVIM DHE RIPOVIM TË JURISPRUDENCËS

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për dhënien e Provimit të Jurisprudencës për afatin e Prill 2024 dhe planifikojnë që të hynë në provim me shkrim me datat 25 dhe 26 Maj 2024 si dhe ata që kanë mbetur në Ri-provim , afati i pagesës do të jetë VETËM ME DATËN 07-08 Maj.2024, DUKE FILLUAR NGA ORA 09:00.

Fletëpagesa merret në Ministrinë e Drejtësisë, kati përdhese të Recepcioni i Ministrisë së Drejtësisë. Do të konsiderohet se është bërë pagesa vetëm atëherë kur kandidati e sjell fletëpagesën e vërtetuar nga Banka .

Ne emër të kandidatit fletëpagesën mund ta marr, paguan dhe ta sjelle në Ministri edhe personi tjetër brenda afatit të përcaktuar për pagesë.